

V E N D I M
Nr.189, datë 6.3.1995

**PËR TRAJTIMIN SHËNDETËSOR TË VETERANËVE TË LUFTËS KUNDËR
PUSHTUESVE NAZIFASHISTË TË POPULLIT SHQIPTAR**

Në bazë të nenit 9 të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të Luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar:
 - a) u sigurohet shtrimi dhe mjekimi falas në të gjitha institucionet shtetërore shëndetësore buxhetore;
 - b) u kryhet mjekimi falas në të gjitha institucionet shëndetësore shtetërore buxhetore stomatologjike, si dhe në klinikën stomatologjike universitare;
 - c) u jepen gratis barnat për mjekim ambulator për kategorinë e sëmundjeve kronike, sipas përcaktimit të bërë nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit.
- Lista e sëmundjeve kronike, për të cilat mjekimi ambulator do të kryhet falas, i bashkëngjitet këtij vendimi.
2. Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit të nxjerrë udhëzimet e nevojshme në zbatim të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

**LISTA E SËMUNDJEVE KRONIKE, PËR TËCILAT MJEKIMI
AMBULATOR DO TË KRYHET FALAS**

- I. Sëmundje të aparatit kardio-vaskular:
 - Sëmundje ishemike të zemrës.
 - Hipertensioni arterial dhe komplikacionet e tij.
 - Çrregullimet kronike të ritmit.
 - Sëmundja okluzive vazale aterosklerotike.
 - Insuficienca kardiake kronike.
- II. Sëmundje të aparatit tretës:
 - Hepatiti kronik.
 - Cirroza e mëlçisë.
 - Sëmundja ulceroze.
 - Kolecisti kronik.
- III. Sëmundje të aparatit të frymëmarrjes:
 - Bronkopneumopatitë kronike.
 - Insuficienca respiratore kronike.
 - Cor pulmonar kronik.
- IV. Sëmundjet renale ose të aparatit urinar:
 - Nefropatitë aterosklerotike.
 - Infeksionet urinare kronike.
 - Insuficiencat renale kronike.
 - Tumoret e prostatës dhe ndërlëkimet e saj.

V. Sëmundjet e aparatit të gjakut:
Anemitë.

VI. Sëmundjet e sistemit nervor:
Hemorragjitë dhe trombozat cerebrale.
Sëmundja e Parkinsonit.
Demenca senile.
Gjendjet depressive.
Sëmundjet degjenerative.
Psikozat.

VII. Sëmundjet e aparatit kockor:
Spondiloatropatitë.
Osteoporoza.

VIII. Sëmundjet e aparatit të shikimit:
Glaukoma.

IX. Sëmundjet e metabolizmit:
Diabeti mellitus.

X. Sëmundjet e indit lidhor (kolagjenit)
Artriti rheumatoid.